

## **Kryetari i KLSH-së zhvillon një vizitë zyrtare në Kroaci**

Në datat 8-9 nëntor, Kryetari i KLSH-së, Z.Bujar Leskaj zhvilloi një vizitë zyrtare dy ditore në Kroaci me ftesë të Auditorit të Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, z.Ivan Klesic, me rastin e përfundimit të mandatit 7 vjeçar të z.Leskaj në fund të këtij viti. Takimi i mirëseardhjes u zhvillua në zyrat qendrore të SAI-t Kroat dhe më pas u zhvillua një takim i zgjeruar me drejtues dhe auditues të SAI-t të Kroacisë.

Auditori i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, z.Ivan Klesic bëri një prezantim lidhur me mënyrën e organizimit dhe të funksionit të SAI-t kroat. Kjo zyrë ka qendrën në Zagreb dhe ka 20 degë të shpërndara në rajonet kryesore të vendit. Departamentet e auditimit janë organizuar në funksion të subjekteve të audituara dhe llojeve të auditimit. Zyra drejtohet nga Auditori i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Parlamenti i Kroacisë dhe propozohet nga komisioni për çështjet administrative, të zgjedhjeve dhe emërimeve. Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë e zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në ligjin për funksionimin e kësaj zyre dhe ka mandat për të audituar, të ardhurat dhe shpenzimet; pasqyrat financiare dhe transaksionet financiare; entitetet publike, kompanitë dhe personat legalë, në të cilët shteti ka shumicën e aksioneve; përdorimin e fondeve të BE-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare lidhur me përdorimin e këtyre fondeve për nevoja publike. Zoti Klesic vijoi prezantimin e tij me mënyrën e raportimit të SAI-t në parlament, politikat e burimeve njerëzore, të komunikimit dhe transparencës, etj.

Më pas Kryetari i KLSH-së zhvilloi një leksion me drejtues dhe auditues të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë. Zoti Leskaj pasi bëri një prezantim të shkurtër të KLSH-së dhe më pas mbështetur dhe në moton e Kongresit të IX-të të EUROSAT-t, të zhvilluar në Holandë : “Kur është hera e fundit që keni bërë diçka për herë të parë ? ”, përcolli përpara audituesve kroatë 10 risitë që janë implementuar për herë të parë në KLSH këto shtatë vitet e fundit :

1. Miratimi i Ligjit të Ri të KLSH-së në nëntor të vitit 2014, i cili e solli veprimtarinë e KLSH-së në përputhje me standartet e INTOSAI-t;
2. Zhvillimin e auditimeve të Performancës, duke filluar nga viti 2012 (deri tani janë realizuar 80 auditime performance);
3. Zhvillimin e auditimeve të IT, duke filluar nga viti 2015 (deri tani janë realizuar 15 auditime IT);
4. Kallëzimet penale, të cilat nuk kanë qenë qëllim në vetvete për KLSH-në por i kanë shërbyer luftës kundër korrupsionit. Që nga viti 2012 deri tani, KLSH ka bërë 299 kallëzime penale, që do të thotë një kallëzim penal në javë;
5. Botimet e KLSH-së, të cilat deri në fund të vitit 2018 do të jenë 101(në shtatë vjet), ndërkohë që në 20 vjet KLSH ka pasur vetëm 12 publikime (1991-2011);
6. KLSH ka botuar një revistë kërkimore shkencore, në gjuhën shqipe dhe angleze, në shtatë vjet 20 numra të kësaj reviste;
7. Muaji i Hapur, i cili në kuadër të transparencës së aktivitetit të institucionit është zhvilluar për disa vite radhazi dhe ka pasur një impakt të gjerë në publik;

8. Gjashtë Konferencat shkencore të KLSH-së, e para është zhvilluar në vitin 2012 dhe e shtata do të zhvillohet në datat 12-13 dhjetor 2018;

9. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe, Universitetet dhe veçanërisht me OJF-të (në total 57 marrëveshje, 30 nga të cilat me OJF-të);

10. Vendosja e stafit të KLSH-së në godinën e re dhe zhvillimi i aktivitetit auditues në kushte komode.

Gjithashtu Kryetari i KLSH-së vlerësoi implementimin e projektit të binjakëzimit nga pala kroate dhe polake dhe u fokusua në komponentët dhe misionet e zhvilluara nga ekspertët kroatë, auditimet e performancës dhe kontrolli i cilësisë. Gjatë implementimit të projektit u realizuan 107 misione, 10 takime pune, mbi 100 drejtues dhe auditues morën pjesë në takime pune dhe në trajnime me ekspertët polakë dhe kroatë, etj. Delegacioni zhvilloi edhe një vizitë në Bashkinë e qytetit të Vinodolit, në bibliotekën dhe në vendin e lindjes të piktorit Juraj Julije Kloviç (1498 - 5 janar 1578), i cili ishte një iluminator, miniaturist dhe piktor i lindur në Mbretërinë e Kroacisë, i cili ishte kryesisht aktiv në Italinë e Rilindjes. Ai konsiderohet si iluminatori më i madh i Rilindjes së Lartë Italiane, dhe me sa duket artisti i fundit shumë i njohur në traditën e gjatë të dorëshkrimit të ndriçuar, para disa risive moderne.

Kryetari i Bashkisë së Vinodolit, z. Marinko Karliç i rezervoi delegacionit të KLSH-së një pritje shumë të përzemërt dhe e nderoi Kryetarin e KLSH-së me titullin “Qytetar nderi” i Vinodolit, përmes një ceremonie të mirë-organizuar, me shumë të ftuar, duke përcjellë shumë emocione pozitive. Në ceremoni ishin ftuar edhe instrumentistë dhe grupe folklorike të zonës.

Biblioteka e vjetër në qendër të ishullit të Krk ishte shumë interesante dhe me libra që i kanë rezistuar kohës edhe gjatë luftërave (veçanërisht gjatë luftës së dytë botërore), falë përkushtimit të banorëve të qytezës. Biblioteka kishte në fondin e saj 10 000 libra të zhanreve të ndryshme që nga viti 1898.

Kryetari i KLSH-së shoqërohej në këtë vizitë nga z. Rinald Muça, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës, zj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe zj. Amantja Patozi, specialiste pranë kësaj Drejtorie. Vizita e arriti qëllimin e saj dhe kaloi në një atmosferë shumë miqësore.